



**MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT  
NDËRMJET  
PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA  
DHE  
KOMUNËS SË LIPJANIT**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) lidhet mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), një organ ndihmës i Kombeve të Bashkuara dhe organizatë ndërqeveritare e themeluar nga Shtetet Anëtare me seli në Nju Jork (SHBA), dhe Komunës së Lipjanit (Komuna). Në tekstin e mëtejshëm UNDP-ja dhe Komuna quhen veçmas si një "Palë" dhe së bashku si "Palët":

**DUKE QENË SE** UNDP-ja shërben në shumë aspekte si krahu operativ i Kombeve të Bashkuara në nivel vendi, dhe punon me partnerë në shumë vende për të nxitur, ndër të tjera, zhvillimin e qëndrueshëm, çrrënjosjen e varfërisë, avancimin e grave, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit;

**DUKE QENË SE** UNDP-ja është e interesuar të zgjerojë aktivitetet e veta zhvillimore siç përshkruhet në Dokumentin e vet të Përbashkët të Planifikimit.

**DUKE QENË SE** Palët dëshirojnë të bashkëpunojnë në fushat me interes të ndërsjellë për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të tyre për zhvillim;

**TANI, PËR KËTO ARSYE,** Palët dëshirojnë të shprehin qëllimin e tyre të bashkëpunojnë si më poshtë:

**Neni I  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

Qëllimi i këtij MM-je është të sigurohet një kornizë për bashkëpunim jo-ekskluziv dhe të lehtësohet dhe forcohet bashkëpunimi mes Palëve në fushat me interes të përbashkët të identifikuara në Nenin II më poshtë.

**Neni II  
Fushat e Bashkëpunimit**

Memorandum Mirëkuptimi  
UNDP dhe Komuna e Lipjanit

Palët kanë identifikuar aktivitetet e mëposhtme për të cilat mund të kërkohe bashkëpunimi, me secilën Palë që operon në varësi të mandateve, rregulloreve qeverisëse, rregullave, politikave dhe procedurave të veta përkatëse, si dhe duke i bashkuar përpjekjet teknike dhe financiare për rehabilitimin e Qendrës Historike të Janjevës, si më poshtë:

- i) Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit si pjesë tejet e rëndeshishme e infrastrukturës, e cila mbështet zhvillimin ekonomik dhe kontribuon në mirëqenien e banorëve të Janjevës. Komuna merr përsipër të kryejë matjet në terren dhe ta mbështesë UNDP-në për të përgatitur specifikimet teknike të nevojshme për projektimin e planit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit për Qendrën Historike të Janjevës dhe rrethinën e saj. UNDP-ja merr përsipër të përgatisë dhe prjektoj planin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit për Qendrën Historike të Janjevës dhe rrethinën e saj;
- ii) Përmirësimi i hapësirave publike dhe dimensionit publik, duke përfshirë infrastrukturën, për krijimin e mundësive për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit, me fokus të shtuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për banorët e Janjevës. Bashkëpunim për marrjen e lejeve dhe aprovimeve të tjera sipas nevojës, për aktivitete të ndryshme, si aktivitete kulturore dhe sportive, zhvillim turistik dhe i atraksioneve, intervenime infrastrukturore etj.;
- iii) Koordinimi i aktiviteteve dhe krijimi i një kornize që identifikon atraktivitetin e Janjevës, si destinacion turistik;
- iv) Mbështetja e zhvillimit ekonomik të Janjevës.

**Neni III**  
**Konsultimet dhe shkëmbimi i informacionit**

3.1 Palët, në baza të rregullta, do ta mbajnë njëra tjetrën të informuar dhe do të konsultohen për çështje me interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre ka gjasa të çojnë në bashkëpunim të ndërsjellë.

3.2 Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve sipas këtij MM-je nuk do t'i cenojë aranzhimet që mund të kërkohe për të ruajtur karakterin konfidencial dhe të kufizuar të disa informatave dhe dokumenteve. Aranzhimet e tilla do t'i mbijetojnë përfundimit të këtij MM-je dhe çdo marrëveshjeje të nënshkruar nga palët në kuadër të fushëveprimit të këtij bashkëpunimi.

Memorandum Mirëkuptimi  
UNDP dhe Komuna e Lipjanit

3.3 Palët, në intervale të tilla që konsiderohen të përshtatshme, do të organizojnë takime për të shqyrtuar ecurinë e aktiviteteve që po kryhen në kuadër të këtij MM-je dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.

3.4 Palët mund ta ftojë njëra tjetrën për të dërguar vëzhgues në takime ose konferenca të thirrura prej tyre ose nën patronatin e tyre, ku sipas mendimit të secilës Palë, tjetra mund të ketë interes. Ftesat do t'i nënshtrohen procedurave të zbatueshme për takimet apo konferencat e tilla.

**Neni IV**  
**Vizibiliteti**

Palët e njohin rëndësinë e sigurimit të vizibilitetit së bashkëpunimit të tyre në kuadër të këtij MM-je dhe për këtë arsye dakordohen të pranojnë rolin dhe kontributin e secilës Palë në të gjithë dokumentacionin për informim publik në lidhje me aktivitetet e përfshira në këtë MM. Palët dakordohen të përdorin emrin dhe logon e secilës Palë në përputhje me rregulloret dhe politikat e secilës Palë dhe me njoftim paraprak me shkrim prej secilës Palë.

**Neni V**  
**Afati, ndërprerja, rinovimi, ndryshimi**

5.1 Bashkëpunimi i propozuar në kuadër të këtij MM-je është jo-ekskluziv dhe do të ketë një afat fillestar prej tre vitesh nga Data e hyrjes në fuqi, siç përcaktohet në nenin X (Efektshmëria) përveç nëse ndërpritet më herët nga secila Palë, duke i dhënë palës tjetër njoftim paraprak me shkrim dy (2) muaj më herët. Palët mund të dakordohen ta zgjasin me shkrim këtë Memorandum Mirëkuptimi për një ose disa periudha të mëvonshme sipas të njëjtave terma dhe kushte.

5.2 Ndërprerja e këtij MM-je nuk do të ndikojë në asnjë marrëveshje tjetër në lidhje me çështjen e këtij MM-je, i cili, përveç nëse ndërpritet ose skadon, do të vazhdojë të rregullojë marrëdhëniet mes Palëve në përputhje me termat e veta.

5.3 Ky MM mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim mes Palëve, të nënshkruar nga përfaqësuesit e tyre të caktuar si duhet.

**Neni VI**  
**Njoftimet**

Memorandum Mirëkuptimi  
UNDP dhe Komuna e Lipjanit

Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet ose të bëhet sipas këtij MM-je duhet të bëhet me shkrim. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të konsiderohet të jetë dhënë ose bërë në mënyrë të rregullt kur dorëzohet me dorë, postë të certifikuar, korrier, teleks ose telegram, tek pala të cilës duhet t'i jepet, ose në adresën e specifikuar më poshtë ose në një adresë tjetër që do të njoftohet në vijim.

Për UNDP-në:	Z. Niels Knudsen Zëvendës Përfaqësuese e Përhershme UNDP Kosovë Rruga e Zagrebit, nr. 58, Arbëri, 10000, Prishtinë
Për Komunën:	Z. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës së Lipjanit Rruga Shqipëria, nr. 28 (14000): Lipjan

**Neni VII**  
**Dispozitat ligjore në lidhje me zbatimin**

7.1 Pavarësisht nga ndonjë gjë në këtë MM për të kundërtën, (a) ky MM është shprehje e qëllimit dhe nuk përbën një dokument ligjorisht të detyrueshëm; (b) asgjë këtu nuk do të interpretohet sikur krijon një angazhim ligjorisht të detyrueshëm, financiar ose tjetër; (c) asgjë këtu nuk do të interpretohet sikur krijon një ndërmarrje të përbashkët dhe asnjëra Palë nuk do të jetë agjente, përfaqësuese ose partnere e përbashkët e Palës tjetër; (d) të gjitha aktivitetet e UNDP-së të parapara më poshtë i nënshtrohen disponueshmërisë së fondeve; (e) të gjitha fondet e marra nga UNDP-ja do të përdoren, dhe të gjitha aktivitetet e UNDP-së përtej këtij MM-je do të kryhen, në përputhje me dokumentet e projektit të dakorduar mes UNDP dhe qeverisë përkatëse të programit ku do të zbatohen aktivitetet, dhe në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e zbatueshme të UNDP-së; dhe (f) secila Palë do të jetë përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet e veta dhe ato të të punësuarve, kontraktorëve dhe nënkontraktorëve të vet në lidhje me këtë MM dhe zbatimin e tij.

7.2 Në masën që Palët dëshirojnë të krijojnë detyrime ligjore ose financiare në lidhje me ndonjë aktivitet të paraparë në këtë MM ose që rezultojnë prej tij, mes Palëve do të lidhet një marrëveshje e veçantë në lidhje me këtë para se të ndërmerret një veprimtari e tillë.

7.3. Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën, kur është e përshtatshme dhe nëse rrethanat e kërkojnë, për çështje që lidhen me pronën intelektuale dhe të drejtat përkatëse, duke përfshirë nevojën për lidhje të marrëveshjes (marrëveshjeve) të veçanta për rregullimin e çështjeve dhe të drejtave të tilla.

Memorandum Mirëkuptimi  
UNDP dhe Komuna e Lipjanit

7.4. Komuna e Lipjanit siguron se i ka të gjitha kompetencat, autoritetin dhe kapacitetin ligjor të nevojshëm për ta lidhur këtë MM dhe për t'i kryer detyrimet e veta sipas këtij memorandumi.

7.5 Në rast të mospërputhjes mes ndonjë dispozite të këtij neni VII dhe një dispozite të një pjese tjetër të MM-së, do të mbizotërojë ky nen VII.

### Neni VIII Zgjidhja e kontesteve

Çdo kontest mes UNDP-së dhe Komunës në lidhje me këtë MM do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga Palët përmes negociatave të drejtpërdrejta.

### Neni IX Privilegjet dhe imunitetet

Asgjë në këtë MM ose në lidhje me të nuk do të konsiderohet si heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve të Kombeve të Bashkuara, përfshirë organet e tyre ndihmëse.

### Neni X Efektshmëria

Ky MM do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është nënshkruar siç duhet nga të dy Palët ("Data e hyrjes në fuqi").

**DUKE DËSHMUAR SA MË LART**, përfaqësuesit e Palëve të autorizuar në mënyrë të rregullt vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.

**PËR UNDP-në:**

**Niels Knudsen**  
Emri

**Zëvendës Përfaqësuese e Përhershme**

Titulli  
DocuSigned by:

*Niels Knudsen*

Data

12-Aug-2022

**Për Komunën e Lipjanit:**

**Imri Ahmeti**  
Emri

**Kryetar**  
Titulli

Data

12/08/2022

